

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje preparate për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 24455000-8 – Dizinfektues, 24456000-5 - Dezinfektues, 24452000-7 - Deratizues

VLERA E FONDIT LIMIT:

53 000 400 (pesedhjetë e tre milion e katërqind) **Lekë pa Tvsh.**

Vlera e fondit limit në monedhën ndërkombëtare euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është **536 549** (peseqind e tridhjetë e gjashtë mijë e peseqind e dyzet e nente) **Euro pa Tvsh.**

P.s Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë për monedhën euro në datë 07.02.2025 është 98.78 (nëntëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e tete).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.3 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit”, Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, VKM Nr.667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit. Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një vërtetim për

xhiron e tre viteve të fundit nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme ku shumatorja e vlerave për furnizimet e ngjashme të jetë minimalisht **20 670 156 (njezet milion e gjashtëqind e shtatedhjetë**

mije e njeqind e pesedhjetë e gjashtë) Lekë pa Tvsh, që përbën 39% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të ulët se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të ulët se 39 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik. Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/ distributori të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF), ose autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për mallrat objekt të prokurimit. Në rast paraqitje deklaratë furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një akt marrëveshje/bashkëpunimi të vlefshme, midis prodhuesit dhe distributorit ose çdo akt tjetër që prodhuesi i një produkti i jep të drejtën e tregëtimit një kompanie tjetër. Deklarata e furnizimit/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit ose autorizimi i prodhuesit /distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e

kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë alternative (do të konsiderohen të barazvlefshme dhe deklaratat me shkrim të furnizimit dhe autorizimi i prodhuesit) i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi produkte insekticidë, adulticidë dhe rodenticidë (*produktet me Nr.3,4,5,6,7,8, dhe 10 në tabelën e Shtojcës 7*), duhet të paraqesë autorizim për bërjen të disponueshme në treg ose autorizim importi të produkteve biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 8 pika 1 e Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se përmbushin kriteret ligjore për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues për të gjitha mallrat objekt prokurimi, duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike dhe mënyrën e përdorimit të produkteve. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi, insekticidë, adulticidë, rodenticidë, repellentë dhe higjenizues (*produktet me Nr.1,2,3,4,5,6,7,8,10, dhe 11 në tabelën e Shtojcës 7*), duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuar/publikuar nga prodhuesi/it..

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat

provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me produkte biocide të cilat do të përdoren në objekte publik, shkollë dhe parashkollë, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që për garantimin e cilësisë së mallit nga vetë natyra e përdorimit është shumë e rëndësishme përmbushja e specifikimeve teknike pasi do të përdoren në ambiente që frekuentohen nga fëmijë të moshës 6 muajsh deri 18 vjeç dhe në ambiente ku zhvillohet aktiviteti mësimor.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose qira të paktën 1 (një) automjet ATP (automjet i transportit të përzier) me karrocë të mbuluar. Për këtë duhet të paraqesë, Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin të vlefshme, ose në rast se e merr automjetin me qira të paraqesë kontratën e qirasë dhe dokumentacionin shoqërues për qarkullimin e automjetit (Lejen e Qarkullimit, Siguracionin, Kolaudimin) të vlefshme.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për Transportet Rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi nr.15, datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor", neni 10 pika 3 e Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi dhe shpërndarja e mallrave me rrezikshmëri për mjedisin, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objekteve në të cilat do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion në paketim origjinal për produktet objekt prokurimi. Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistemin e publikimeve elektronike (SPE).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.487 pika 7, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”, Udhëzimin nr.3478 datë 05.05.2014 “Për etiketimin dhe ambalazhimin e produkteve biocide, dezinfektuese, dezinfektuese, deratizuese për përdorim në shëndetin publik”, të Ministrisë së Shëndetësisë. Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga rëndësia që ato kanë për shkak të funksionalitetit special të tyre. Në këtë rast paraqitja e mostrave është konsideruar nga autoriteti kontraktor si e nevojshme pasi verifikimi fizik i tyre është gjykuar i rëndësishëm për të vlerësuar detyrimet ligjore të ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve, sigurinë gjatë furnizimit së produkteve dhe sigurinë ndaj përdoruesve të tyre.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm përbërë nga specialistë të fushës, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, Ligjit nr.27/2016 datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, VKM nr.933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Produktet e kërkuara janë të rëndësishme në ushtrimin e detyrave funksionale të autoritetit kontraktor. Këto produkte garantojnë marrjen e masave efikase për parandalimin e infeksioneve nga viruset, bakteret, kërpudhat sipas detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Karakteristikat teknike dhe përbërësit kimikë të produkteve janë kërkuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”. Standartet teknike të kërkuara janë konsultuar me bazën ligjore në fuqi ku është verifikuar përcaktimi teknik për çdo element në veçanti. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës,*

nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.